

UDHËZIM
Nr. 20, datë 3.10.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 5, DATË 19.2.2016, “MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 758, DATË 16.9.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT “PËR PAJISJEN ME DEKODERA TË FAMILJEVE NË NEVOJË, PËRFITUESE NGA SKEMA E NDIHMËS EKONOMIKE DHE PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR PËR KËTË MINISTRI””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 10 e 13, të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të nenit 10, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të nenit 22, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” dhe të pikës 4, të vendimit nr. 758, datë 16.9.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për ngarkimin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për kryerjen e procedurave të prokurimit për pajisjen me dekodera të familjeve në nevojë, përfituese nga skema e ndihmës ekonomike dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2015, miratuar për këtë ministri”,

UDHËZOJ:

1. Pika 6 e udhëzimit nr. 5, datë 19.2.2016 riformulohet me këtë përmbajtje:

“6. Shpërndarja e dekoderave në familjet në nevojë, përfituese të skemës së ndihmës ekonomike, do të realizohet në mënyrë progresive në përputhje me rendin dhe afatet e digjitalizimit të transmetimeve audiovizive, të miratuara nga Komiteti Ndërinstitucional për zbatimin e strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Shërbimi Social Shtetëror njoftohen menjëherë mbi vendimin e Komitetit Ndërinstitucional për rendin dheafatet e digjitalizimit të transmetimeve audiovizive dhe fillojnë shpërndarjen e dekoderave duke llogaritur kohën e nevojshme për t’i paraprirë afatit të mbylljes së transmetimeve analoge.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Blendi Klosi**